

“KALO & ASSOCIATES” Shpk

Pasqyrat Financiare të Audituara

Për ushtrimin e mbyllur më
31 Dhjetor 2010

PERMBAJTJA:

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR	1
BILANCI KONTABEL	2
BILANCI KONTABEL (VAZHDIM)	3
PASQYRA E TE ARDHURAVE E SHPENZIMEVE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN EVET	5
PASQYRA E LEVIZJES SË FLUKSIT TE PARAVE	6
1. informacion i pergjithshem	7
2. permbledhje e politikave te rendesishme kontabile	
3. sistemi kontabel	
4. mjete monëtare	
5. kerkesa te arketueshme	
6. KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME	
7. parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	
8. aktivet afatgjata materiale	
9. HUATE DHE OBLIGACIONËT AFATSHKURTRA	
10. TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE dhe detyrime te tjera tatimore	
11. shpenzime te tjera	
12. tatimi mbi fitimin	

RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR

Ortakëve të shoqërisë “Kalo & Associate” Shpk

Rr. Kavajes, G-KAM Center, Tiranë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkalidhur të shoqërisë “Kalo & Associate” shpk (Shoqëria), të cilat përbëhen nga bilanci kontabël i datës 31 Dhjetor 2010, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet, dhe pasqyra e flukseve të parave për vitin ushtrimor të mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje të metodave të rëndësishme kontabël dhe shenimeve të tjera anekse.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e cmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë ketu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin vlerësimin e parimeve kontabile të përdorura dhe të cmuarjeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë se auditimi jep një bazë të arsyeshme për opinionin tonë.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të shoqërisë japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë “Kalo & Associate” shpk me 31 Dhjetor 2010, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave, për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standartet Kombëtare të Raportimit Financiar.

E & B Auditing

25 Mars 2011

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare
 Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010
 BILANCI KONTABËL

	AKTIVET	Shenim	2010	2009
I	Aktivet Afatshkurtra			
1	Mjete monetare	<u>4</u>	32,044,740	30,904,578
2	Derivative dhe aktive financiare te mbajtura per tregtim		-	-
i	Derivativet			
ii	Aktivet e mbajtura per tregtim			
	Shuma I.2		-	-
3	Aktive te tjera afatshkurtra financiare			
i	Llogari/Kerkesa te arketueshme		18,958,396	18,487,073
ii	Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme		4,255,345	3,505,262
iii	Instrumente te tjera borxhi			
iv	Investime te tjera financiare			
	Shuma I.3	<u>5</u>	23,213,741	21,992,335
4	Inventari			
i	Lendet e para			
ii	Prodhim ne proces			
iii	Produkte te gatshme			
iv	Mallra per rishitje			
v	Parapagesat per furnizime			
	Shuma I.4	-	-	-
5	Aktivet biologjike afatshkurtra			
6	Aktivet afatshkurtra te mbajtura per shitje			
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	<u>6</u>	4,958,854	6,365,570
	Totali per Aktivet Afatshkurtra		60,217,335	59,262,484
II	Aktivet Afatgjata			
1	Investimet financiare afatgjata			
i	Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara			
ii	Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje			
iii	Aksione dhe letra te tjera me vlere			
iv	Llogari/Kerkesa te arketueshme afatgjata			
	Shuma II.1		-	-
2	Aktive afatgjata materiale			
i	Toka			
ii	Makineri dhe pajisje		-	-
iii	Aktive te tjera afatgjata materiale		11,205,933	10,663,815
iv	Ndertesa		-	-
	Shuma II.2		11,205,933	10,663,815
3	Aktivet biologjike afatgjata			
4	Aktivet afatgjata jomateriale			
i	Emri i mire			
ii	Shpenzimet e zhvillimit			
iii	Aktive te tjera afatgjata jomateriale			
	Shuma II.4		-	-
5	Kapital aksionar i papaguar			
6	Aktive te tjera afatgjata (ne proces)			
	Totali per Aktivet Afatgjata	<u>7</u>	11,205,933	10,663,815
	Totali i Aktiveve		71,423,268	69,926,299

Pasqyrat financiare nga faqja 2 deri 10 jane firmosur dhe miratuar me 28 Mars 2011 nga:

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010

Administrator

Financiere

BILANCI KONTABËL (VAZHDIM)
më 31 Dhjetor, 2010

	DETYRIMET	Shenim	2010	2009
I	Detyrimet Afatshkurtra			
1	Derivativet (vlera negative)			
2	Huamarrjet			
i	Huat dhe obligacionet afatshkurtra	<u>8</u>	3,578,036	5,323,039
ii	Kthimet/ripagesat e huave afatgjata			
iii	Bono te konvertueshme			
	Shuma I.2	-	3,578,036	5,323,039
3	Huat dhe parapagimet			
i	Te pagueshme ndaj furnitoreve	-	1,723,001	65,777
ii	Te pagueshme ndaj punonjesve			7,201
iii	Detyrimet tatimore		2,934,368	7,236,997
iv	Hua te tjera		2,764,612	4,129,059
v	Parapagimet e arkëtuara		-	2,795,325
	Shuma I.3	<u>9</u>	7,421,981	14,234,359
4	Grantet dhe te ardhurat e shtyra		-	-
5	Provizionet afatshkurtra		-	-
	Totali per Detyrimet Afatshkurtra		11,000,017	19,557,398
II	Detyrimet Afatgjata			
1	Huat afatgjata			
i	Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare			
ii	Bonot e konvertueshme			
	Shuma II.1		-	-
2	Huamarrje te tjera afatgjata			
3	Provizionet afatgjata			
4	Grantet dhe te ardhura te shtyra			
	Totali per Detyrimet Afatgjata		-	-
	Totali i detyrimeve		11,000,017	19,557,398
	KAPITALI			
I	Kapitali		6,800,000	6,800,000
1	Aksionet e pakices			
2	Kapitali qe i perket aksionareve te shoqerise meme			
3	Kapitali aksionar			
4	Primi i aksionit			
5	Njesite ose aksionet e thesarit			
6	Rezerva			
i	Rezerva ligjore		80,429	80,429
ii	Rezerva te tjera			
iii	Rezerva statuoare			
	Shuma I.6		80,429	80,429
7	Fitimet e pashperndara		29,000,000	
8	Fitimi/Humbja e vitit financiar		24,542,823	43,488,472
	Totali per Kapitalin	-	60,423,252	50,368,901
	Totali i Detyrimeve dhe i Kapitalit		71,423,268	69,926,299

Pasqyrat financiare nga faqja 2 deri 10 jane firmosur dhe miratuar me 28 Shkurt 2011 nga:

Administrator

Financiere

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare
 Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010

PASQYRA E TË ARDHURAVE E SHPENZIMEVE
 Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor, 2010

Nr.	PERSHKRIMI	Shenime	2010 leke	2009 leke
1.	Shitjet neto	10	128,023,636	134,930,807
2.	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit		-	-
3.	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		-	-
4.	Materialet e konsumuara		-	-
5.	Kosto e punës	11	55,059,297	40,299,060
6.	Amortizimet dhe zhvlerësimet		2,648,770	2,521,979
7.	Shpenzime të tjera	12	43,036,007	41,868,875
8.	Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)		100,744,073	84,689,914
9.	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)		27,279,563	50,240,893
10.	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		-	-
11.	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-	-
12.	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		-	-
12.1.	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata		-	-
12.2.	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat		(417,101)	(317,777)
12.3.	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi		1,135,623	574,765
12.4.	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		-	(2,122,582)
13.	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (10+11+12.1+12.2+12.3+12.4)	13	718,522	(1,865,594)
14.	Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)		27,998,084	48,375,299
15.	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	14	3,455,261	4,886,827
16.	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)		24,542,823	43,488,472
17.	Elementët e pasqyrave të konsoliduara		0.0	0.0

Pasqyrat financiare nga faqja 2 deri 10 jane firmosur dhe miratuar me 28 Shkurt 2011 nga:

Administrator

Financiere

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN EVET
Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor, 2010

	Kapitali aksionar	Rezerva Ligjore	Fitime Humbje te mbartura	Total
	LEK	LEK	LEK	LEK
Bilanci date 1 Janar 2010	6,800,000	80,429	43,488,472	50,368,901
Emetim I kapitalit aksionar	-	-	-	-
Divident i paguar			(14,488,472)	(14,488,472)
Fitim Humbje te mbartura			-	-
Humbje / Fitim per periudhen	-		24,542,823	24,542,823
Bilanci date 31 Dhjetor 2010	6,800,000	80,429	53,542,823	60,423,252

Pasqyrat financiare nga faqja 2 deri 10 jane firmosur dhe miratuar me 28 Shkurt 2011 nga:

Administrator

Financiere

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare
 Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010

PASQYRA E LËVIZJES SË FLUKSIT TË PARAVE

Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit	2010 LEK	2009 LEK
Fitimi para tatimit	27,998,084	48,375,299
Rregullime per Amortizimin	2,648,770	2,521,979
Humbje nga kembimet valutore	0	0
Te ardhura nga investimet	0	0
ShpenZime per interesa	-	-
Rritje / renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti si dhe kerkesave te arketueshme te tjera	(79,324)	(12,616,024)
Rrite/renie ne tepricen e inventarit	0	0
Rrite/renie ne tepricen e detyrimeve per tu paguar nga aktiviteti	(8,557,381)	1,544,008
Parate e perfituara nga aktivitetet		
Interes I paguar	-	-
Tatim fitimi I paguar	(3,455,261)	(4,886,827)
Fluksi monetar neto nga veprimtarite e shfrytezimit	18,554,887	34,938,434
Fluksi monetar nga veprimtarite investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(3,190,888)	(1,963,492)
Te ardhura nga shitja e pajisjeve	-	-
Interes I arketuar	-	-
Dividente te arketuar	-	-
Fluksi monetar neto nga veprimtaria investuese	(3,190,888)	(1,963,492)
Fluksi monetar nga veprimtarite financiare		
Te ardhura nga emetimi I kapitalit aksionar	-	-
Mjete monetare te arketuara nga kredi	-	-
Pagesat e detyrimeve te qirase financiare	-	-
Dividentet e paguar	(14,488,472)	(9,358,080)
Fluksi monetar neto nga aktivitetet financiare	(14,488,472)	(9,358,080)
Rritja/ renia neto e mjeteve monetare	875,527	23,616,862
Mjetet monetare ne fillim te periudhes	30,904,578	7,287,716
Mjetet monetare ne fund te periudhes	31,780,106	30,904,578

Pasqyrat financiare nga faqja 2 deri 10 jane firmosur dhe miratuar me 28 Skurt 2011 nga:

Administrator

Financiere

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

“Kalo & Associates” shpk (shoqëria) është krijuar si me vendim të Gjykatës së rrethit Tiranë e regjistruar në regjistrin tregtar nr. 33260 datë 29/03/2005, në përputhje me ligjin “Për Shoqëritë Tregtare” nr.7638 datë 19 Nëntor 1992.

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është ai i shërbimeve ligjore, në fushën civile dhe penale, personave fizikë dhe juridikë, shqiptarë apo të huaj, përgatitje të dokumentacionit ligjor etj.

Ortakë të shoqërisë janë:

	Emri i ortakut	Vlera e kapitalit Leke '000	% në kapital
1	Perparim Kalo	4.760	70%
2	Alban Caushi	1.020	15%
3	Ardjana Kalo	1.020	15%

Administrator i shoqërisë është Z. Perparim Kalo

Selia e shoqërisë është G-KAM Center, Kati I IV-te, Rr. Kavajës, Tiranë. Shoqëria është e regjistruar në Njesinë e Tatim paguesve dega Tiranë me NIPT: K 31910009 D.

Administratori

Financieri

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE

a. Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur, ne te gjithe aspektet materiale, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK), te cilat perbehen nga regullat dhe interpretimet ne perputhje me Ligjin nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike. Te dhenat aktuale dhe krahasuese jane prezantuar ne Lek Shqiptare (LEK), qe eshte monedha raportuese e shoqerise.

b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

c. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek, e cila eshte dhe monedha funksionale e shoqerise.

d. Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te kompanise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

Ne vecanti, informacion mbi fushtat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kanë efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare. Përdorimi i vleresimeve kontabel eshte minimal ne keto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtesine e veprimeve te realizuara nga shoqeria.

3. POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabel te meposhteme jane aplikuar per periudhen qe fillon me 1 janar 2010 deri me 31 dhjetor 2010.

a. Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare te paraqitura ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes se transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e gjendjeve te bilancit emertuar ne monedhe ne huaj jane si me poshte (ne LEK):

	<u>31 Dhjetor 2010</u>	<u>31 Dhjetor 2009</u>
1 EUR	138.77	137.96
1 USD	104	95.81

b. Instrumenta financiar

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhës së raportuar nuk ka patur investime ne kapital apo instrumenta borxhi të përdorura gjatë aktivitetit.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimë të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi financiar, dhe mospagesa apo kundravajtje ne pagesa (mbi 30 ditë vonesë) konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huaatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv .

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksioner

Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale. Aksionet e preferuara të detyrueshme me të drejtë riblerjeje klasifikohen si detyrime.

c. Aktive e afatgjata materiale dhe jomateriale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit mbarten në “Ndërtim në proces” dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afat-gjate materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jeten e vlerësuar të cdo pjese të aktivitet afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet. Toka nuk amortizohet.

Normat vjetore të amortizimit të përdorura janë si më poshte:

Kategoria	Norma e amortizimit %		Metoda e llogaritjes
	2009	2008	
Instalime	20	20	Vlera kontabile e mbetur
Mjete transporti	20	20	
Mobilje orëndi	20	20	
Pajisje elektronike	25	25	

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo date raportimi.

d. Zhvlerësimi

(i) aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Cdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivët afatgjata materiale dhe jomateriale janë njohur si të tilla nëse parashikohet që shoqëria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike që kanë lidhje me atë aktiv dhe kosto e aktivit mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera e mbajtjes së aktiveve të qëndrueshme duhet të rishikohet nëse është zhvlerësuar kur ndodhin ndryshime ose ndryshime në rethanat tregojnë se vlera e mbajtjes mund të jetë e parikuperueshme. Nëse këto të dhëna ekzistojnë dhe atëherë kur vlera e mbajtjes kalon vlerën e parashikuar të rikuperueshme, aktivi zhvlerësohet në vlerën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

e. Njohja e të ardhurave dhe shpenzimet

Të ardhurat janë njohur atëherë kur shoqëria do të ketë të mundur të marrë përfitime ekonomike dhe këto përfitime mund të vlerësohen me siguri (dhe jo domosdoshmerisht kur është arketuar). Shpenzimet janë njohur në pasqyrën e të ardhura-shpenzimeve atëherë kur kanë ndodhur (dhe jo domosdoshmerisht kur është paguar). Të ardhurat dhe shpenzimet janë regjistruar në pasqyrat financiare të periudhës së ciles ato i perkasin.

f. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv

g. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin janë llogaritur në përputhje me dispozitat e ligjit për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë. Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë gjithë detyrimet për tatimin mbi fitimin e këtij viti ushtrimor. Tatimi mbi fitimin i këtij viti ushtrimor është - llogaritur me 10% fitimit të tatueshem sipas normave fiskale në Shqipëri.

4. MJETE MONETARE

Arka, banka dhe likuiditete të tjera analitikisht me 31 Dhjetor 2010, 2009 janë:

	2010	2009
Vlera monetare arka	323,625	1,999,259
Vlera monetare banka	31,721,115	28,905,320
Depozita	-	-
	32,044,740	30,904,578

5. KLIENTE DHE KËRKESA TË ARKËTUESHME

Kliente dhe kërkesa të tjera analitikisht me 31 Dhjetor 2010, 2009 janë

	2010	2009
Kliente	18,958,396	18,487,073
Paradhenie	3,260,675	3,505,262
Tatim në burim	49,297	-
Tatim fitimi	945,373	-
	23,478,375	21,992,335

6. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA

Parapagime të shtyra analitikisht me 31 Dhjetor 2010, 2009 janë

	2010	2009
Shpenzime të shtyra	6,611,806	7,956,963
Amortizimi vjetor	(1,652,951)	(1,591,393)
	4,958,854	6,365,571

7. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Kategoritë kryesore të aktiveve afatgjata materiale me 31 Dhjetor 2010, 2009, janë si më poshtë:

	<i>Mjete transporti</i>	<i>Mobilje orendi</i>	<i>Pajisje informatike</i>	<i>Total AAM</i>
	<i>LEK</i>	<i>LEK</i>	<i>LEK</i>	<i>LEK</i>
Kosto				
1 Janar 2010	10,365,473	2,266,451	3,074,660	15,706,584
Shtesa	-	285,640	2,905,248	3,190,888
Pakesime / Axhustime	-	-	-	-
31 Dhjetor 2010	10,365,473	2,552,091	5,979,908	18,897,472
Amortizimi				
1 Janar 2010	3,812,131	617,119	613,519	5,042,769
Amortizimi vjetor	1,310,669	412,950	925,151	2,648,770
Rimarje amortizimi				
31 Dhjetor 2010	5,122,800	1,030,069	1,538,670	7,691,539
AAM neto me 01 Janar 2010	6,553,342	1,649,332	2,461,141	10,663,815
AAM neto me 31 Dhjetor 2010	5,242,673	1,522,022	4,441,238	11,205,933

8. HUATË DHE OBLIGACIONET AFATSHKURTRA

Huate analitikisht me 31 Dhjetor 2010, 2009 jane si me poshte:

	2010	2009
Hua Alpha Bank	3,578,036	5,323,039
	3,578,036	5,323,039

9. TË PAGUESHME NDAJ FURNITORËVE DHE DETYRIME TË TJERA TATIMORE

	2010	2009
Furnitore per mallra , produkte e sherbime	1,723,001	65,777
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	557,706	567,294
Tatim mbi te ardhurat e personale	1,095,779	306,190
Detyrime TIA	2,764,613	4,129,059
Te tjera	-	2,795,325
Tvsh	1,280,883	2,667,015
Tatim fitimi		3,696,498
Te pagueshme per punonjesit	-	7,702
	7,421,982	14,234,860

10. SHITJE NETO

Analitikisht te ardhurat e realizuar gjate 2010, 2009 jane si me poshte:

	2010	2009
Sherbime Ligjore	128,023,636	134,930,807
	128,023,636	134,930,807

11. KOSTO TE PUNES

Analitikisht kostot e fuqise punetore 31 Dhjetor 2010, 2009 jane si me poshte:

	2010	2009
Pagat dhe shperblimet e personelit	50,804,201	35,724,134
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	4,255,096	4,574,926
	55,059,297	40,299,060

12. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzimet e tjera analitikisht jane:

	2010	2009
Bl.energji,avull,uje	56,900	48,135
Blerje energji	507,137	370,387
Blerje Telefon	3,055,959	3,877,808
Shpenzim Parkimi	80,000	70,000
Sherbime Kons. ekonomike	1,625,000	1,476,911
Pagesa per bashkepunetoret	4,262,757	4,812,830

Sherbim Vleresimi	-	689,270
Bileta Udhetimi	714,473	1,233,341
Antaresime	320,418	3,139,956
Shp. Pjesmarje	9,986	-
Qira	12,700,416	12,235,827
Mirembajtje dhe riparime	556,159	1,841,994
Te tjera	250,609	421,818
Shpenzime kancelarie	1,085,549	559,258
Perkthime	95,300	-
shpenzime noterie	641,330	819,100
Dizenjim	343,293	770,437
Nafte	1,289,462	703,500
Internet	374,395	221,044
Kuota, abonime	283,901	544,602
Shpenzime per Klientet	715,000	265,000
Shpenz per koncesione, patenta, licensa dhe te ngjashme	121,000	266,776
Publicitet, reklama	-	50,000
Transferime, udhetim, dieta	343,173	2,223,427
Shpz.postare e telekom.	238,236	369,607
Sherbime bankare	730,207	418,387
Sherbime ligjore	1,769,612	-
sigurime jete	334,655	287,322
Taksa Vendore	105,874	110,870
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	541,217	569,292
Sponsorizime	819,508	1,123,424
Gjoha dhe demshperblime	2,884	10,000
Shpenzime te pazbritshme	6,551,645	482,972
Kafe	627,851	264,188
Shpenzime te tjera	229,149	-
kuota e ushtrimit nga shpz e periudhave te ardhme	1,652,951	1,591,393
	43,036,007	41,868,876

13. SHPENZIME FINANCIARE

Analitikisht te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane si me poshte:

	2010	2009
Shpenzime per interesa	421,995	317,777
Humbje nga kembimet valutore	370,924	2,122,582
Ardhura nga konvertimi	(327,108)	(574,765)
Te ardhura nga interesat	(4,894)	
Fitim nga kembimet valutore	(1,179,438)	
	(718,522)	1,865,594

14. TATIM MBI FITIMIN

Shoqëria ka aplikuar normën e tatim fitimit mbështetur në ligjin për të ardhurat Deklarimi i tatimit mbi fitimin për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2010 është si më poshtë:

	2010	2009
Fitimi perpara tatimit	27,998,084	48,375,299
Tatim fitimi i llogaritur me 10%	2,799,808	4,837,530
Efekti tatimor :		
-Te ardhurave Te pa tatueshme	-	-
-Shpenzimeve te pazbritshme per tatim fitimin	655,453	49,297
Rezultati tatimor	24,542,823	43,488,472
Tatim fitimi total	3,455,261	4,886,827

15. SHPENZIME TE PAZBRITSHME

	2010	2009
Gjoha dhe demshperblime	2,884	10,000
Shpenzime te pazbritshme	6,551,645	482,972
	6,554,530	492,972